



UNIVERSITETI I SHKODRES

“Luigj Gurakuqi”

Nr. 3573 Prot.

Shkodër, më 12.10. 2016

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shpallet konkursi për një vend të lirë pune në **Fakultetin e Shkencave të Edukimit**, Departamenti i Edukimit fizik e sporteve, për pozicionin lektor/e me kohë të plotë për lëndët “Lojra sportive, Moduli Basketball” cikli i parë i studimit, “Metodika e lojrave sportive, Moduli Basketball” cikli i dytë i studimit.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere :

- Të kenë kryer shkollën pasuniversitare me diplomë “Master Shkencor” ose gjatë studimeve universitare dhe pasuniversitare të kenë grumbulluar jo më pak se 300 kredite në specialitetin “Basketboll” me notë mesatare jo më të ulët se 9. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MAS-i.
- Të kenë kryer arsimin e lartë në sistemin me kohë të plotë, në profilin “Basketboll” me notë mbi 8.5.
- Nota mesatare e përgjithshme e studimeve në diplomën e sistemit të vjetër të jetë mbi 8,5.
- Të kenë notën mesatare të grup-lëndëve për të cilat konkurrohet, jo më pak se 9.
- Të ketë përfunduar studimet “MSH” në specialitetin “Basketboll” me kohë të plotë, me notë mesatare jo më të ulët se 8.5
- Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore (preferohet anglisht) me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.
- Të kenë dhënë provim universitar dhe/ose pasuniversitar lëndën për të cilën pretendojnë të jenë lektorë.
- Preferohen që kandidatët të kenë:
 1. gradën “Doktor i Shkencave” apo titull akademik “Prof. , prof.as.dr. , docent” etj
 2. eksperiencë pune në mësimdhënie në shkollën e lartë,
 3. të kenë aktivitet botues.
- Shtetasit e huaj duhet të kenë leje pune dhe leje qëndrimi.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Dëshmi Doktorature, MND ose DND dhe e provimeve pasuniversitare (lista e notave) të njohura zyrtarisht. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MAS-i.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurohet.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) dhe mjekësore (kartë shëndeti+librezë shëndetsore).
10. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e Punës.
11. Certifikatë familjare dhe dokument identifikimi vetjak (fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
12. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
13. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

Shënim:

- *Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.*
- *Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore ose Sektorit të Protokoll-arkivës dokumentacionin e mësipërm deri më datë 29.10.2016, ora 12⁰⁰.*
- *Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë me datë 31.10.2016, sipas orarit që do të përcaktojë Departamenti i Edukimit fizik e sporteve.*
- *Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc deri më 05.11.2016.*

- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni Departamentit të Edukimit fizik e sporteve dhe/ose Degës së Burimeve Njerëzore.

Rektorati i Universitetit të Shkodrës

“Luigj Gurakuqi”

